

ZENELI LAW OFFICE sh.p.k.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

| | FAQE |
|---|-------------|
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 2 |
| PASQYRA E PERFORMANCËS | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 4 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE | 5 |
| SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 6–16 |

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

| | Shënime | 31 dhjetor 2019 |
|---|---------|------------------|
| AKTIVET | | |
| Aktive afatshkurtra | | |
| Mjete monetare | 4 | 1,045,882 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 5 | 725,310 |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 6 | 100,000 |
| Shpenzime të shtyra | 7 | 100,390 |
| Total aktive afatshkurtra | | 1,971,582 |
| Aktivet afatgjata | | |
| Aktive afatgjata materiale | 8 | 336,062 |
| Total aktive afatgjata | | 336,062 |
| Total aktive | | 2,307,644 |
| DETYRIMET | | |
| Detyrime afatshkurtra | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 9 | 22,950 |
| Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 10 | 480,878 |
| Detyrime tatimore | 11 | 232,179 |
| Të tjera detyrime | 12 | 256,950 |
| Total detyrime afatshkurtra | | 992,957 |
| Detyrime afatgjata | | |
| Total detyrime afatgjata | | - |
| Totali i detyrimeve | | 992,957 |
| KAPITALI | | |
| Kapitali i nënshkruar | 13 | 100,000 |
| Fitimi i ushtrimit | | 1,214,687 |
| Total kapitali i nënshkruar | | 1,314,687 |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | | 2,307,644 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|--|---------|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 14 | 2,024,025 |
| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | 15 | (6,109) |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | (110,308) |
| 1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 16 | (110,308) |
| Shpenzime të personelit | 17 | (621,619) |
| 1) Paga dhe shpërblime | | (534,045) |
| 2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore | | (87,574) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 8 | (7,371) |
| Të ardhura të tjera | | - |
| Shpenzime financiare | | - |
| Fitimi/humbja para tatimit | | 1,278,618 |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | 18 | (63,931) |
| 1) Shpenzimi actual i tatimit mbi fitimin | | (63,931) |
| Fitimi/humbja e vitit | | 1,214,687 |
| Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin | | - |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin | | 1,214,687 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ZENELI LAW OFFICE sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

| | Kapitali i nënshkruar | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|-----------------------|------------------------|------------------|
| Pozicioni financiar i rideklaruar më 26 shtator 2019 | - | - | - |
| Fitimi / Humbja e vitit | | 1,214,687 | 1,214,687 |
| Lëvizjet përmes kapitalit | | - | - |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | 100,000 | | 100,000 |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019 | 100,000 | 1,214,687 | 1,314,687 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Zeneli Law Office Sh.p.k. më 10 shkurt 2020 dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Arjan Zeneli
Z. Arjan Zeneli Sh.p.k.
Adm. Z. Arjan Zeneli
ZENELI LAW OFFICE
TIRANË - ALBANIA

Mazars Shpk.
Mazars Shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

M MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al | info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

| Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|--|---|
| Flukset e parasë nga aktivitetet operative | |
| Fitim / Humbja e vitit | 1,214,687 |
| Shpenzimet financiare jomonetare | 5,989 |
| Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar | 63,931 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 7,371 |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | (825,700) |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 672,496 |
| Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit | 256,530 |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit | 1,395,304 |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | (343,433) |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | (343,433) |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit | |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit | - |
| Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare | 1,051,871 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 26 shtator 2019 | - |
| Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare | (5,989) |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor | 1,045,882 |

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ZENELI LAW OFFICE" sh.p.k është themeluar më 01 shtator 2019 dhe është regjistruar më 26 shtator 2019 në Regjistrin e Shoqërive me akt themelimi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është, të ofrojë shërbime ligjore dhe konsulenca të ndryshme. Ofrimi i shërbimeve ligjore për individët, personat fizik dhe juridike, shqiptare dhe të huaj. Përfaqësim i këtyre personave në institucione të ndryshme publike e private si dhe përfaqësim në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Konsulencë financiare dhe fiskale, menaxheriale dhe ligjore

Administrator i Shoqërisë është Z. Artan Zeneli.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L92126025E. Selia qendrore e saj është në: Rruga "Mujo Ulqinaku" , Nr, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 ishte 3 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.1. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 31 dhjetor 2019 |
|-------------------------|------------------------|
| Euro/LEK | 121.77 |
| USD/ LEK | 108.64 |

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|---|----------------------|---------------------|
| Ndërtesa | Vlera e mbetur | 5% |
| Instalime teknike, makineri dhe pajisje | Vlera e mbetur | 20% |
| Mjete Transporti | Vlera e mbetur | 20% |
| Mobilje dhe pajisje zyre | Vlera e mbetur | 20% |
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25% |
| Të tjera | Vlera e mbetur | 20% |

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të v

eprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 5%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> |
|-------------------------|-------------------------|
| Mjete monetare në bankë | 1,045,882 |
| Mjete monetare në arkë | - |
| | <u><u>1,045,882</u></u> |

5. Llogari të arkëtueshme tregëtare afatshkurtra

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> |
|---------|------------------------|
| Klientë | 725,310 |
| | <u><u>725,310</u></u> |

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> |
|----------------------------------|------------------------|
| Kapitali i nenshkruar i papaguar | 100,000 |
| | <u><u>100,000</u></u> |

7. Shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> |
|--|------------------------|
| Shpenzime për përshtatje ambjentit të zyrave | 100,390 |
| | <u><u>100,390</u></u> |

8. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

| Kosto | Mobilje orendi | Totali |
|-------------------------------|----------------|---------|
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | - | - |
| Shtesa | 343,433 | 343,433 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 343,433 | 343,433 |
| Amortizimi i akumuluar | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | - | - |
| Amortizimi i vitit | (7,371) | (7,371) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | (7,371) | (7,371) |
| Vlera neto kontabël | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | - | - |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 336,062 | 336,062 |

9. Llogari të pagueshme tregëtare

Llogaritë e pagueshme tregëtare më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 |
|------------------|-----------------|
| Furnitorë vendas | 22,950 |
| | 22,950 |

10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 |
|-------------------------------------|-----------------|
| Të pagueshme tregëtare Artan Zeneli | 480,878 |
| | 480,878 |

11. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 |
|---|-----------------|
| TVSH | 100,905 |
| Tatim fitim | 63,931 |
| Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 52,835 |
| Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi | 13,158 |
| Tatim në Burim | 1,350 |
| | 232,179 |

12. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 |
|-----------------------|------------------------|
| Pagat e punonjësve | 256,530 |
| Financime Mazars Shpk | 420 |
| | 256,950 |

13. Kapitali

Kapitali i shoqërisë ZENELI LAW OFFICE sh.p.k është 100.000 lekë më 31 dhjetor 2019.

Fitimi I vitit është 1,214,687 Lekë.

14. Të ardhura nga nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga shitja më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|
| Të ardhura nga shitja e shërbimeve Juridike | 2,024,025 |
| | 2,024,025 |

15. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|--|---|
| Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit | (7,573) |
| Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit | 1,464 |
| | (6,109) |

16. Lënda e pare dhe material të konsumueshme

Materialet e para të konsumueshme më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|----------------------|---|
| Kancelari | 12,426 |
| Shpenzime qeraje | 27,000 |
| Mirëmbajtje riparime | 66,927 |
| Shpenzime bankare | 3,955 |
| | 110,308 |

17. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|-------------------------------------|---|
| Shpenzime për paga | 534,045 |
| Shpenzime për sigurime shoq e shënd | 87,574 |
| | 621,619 |

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 ishte 3 punonjës.

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|
| Fitimi para tatimit | 1,278,618 |
| Shpenzime të panjohura të tjera | - |
| Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura) | 1,278,618 |
| Tatim fitimi 5% | 63,931 |
| Fitimi i vitit | 1,214,687 |

19. Rakordimi me FDP

| | 31 dhjetor 2019 |
|---|------------------------|
| Rakordimi i të ardhurave me FDP-në | |
| Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së | 2,024,025 |
| Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH | 2,024,025 |
| Shërbime | 2,024,025 |
| Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP | 2,024,025 |
| Fitim nga këmbimet valutore | 1,464 |
| Total të ardhura të deklaruara FDP-në e Tatim Ftimit | 2,025,489 |

20. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

20. Angazhime dhe pasiguri (vazhdim)

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

21. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.